



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

# Newsletter

MARS 2023

## EVENTE PUBLIKE

### PROGRES ME REFORMËN NË DREJTËSI

Mbahet për herë të parë në Tiranë Këshilli i Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri. BE konfirmon mbështetjen për integrimin e Ballkanit Perëndimor ndërsa vlerëson Shqipërinë për progresin nëpërmjet reformës në drejtësi.

[Për më shumë](#)



### Ministri Manja: Mbrojtja e viktimave të krimit, prioritet strategjik

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja lançon hartimin e “Strategjisë Ndërsektorale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030”. Z.Manja, theksoi se viktimat e krimit meritojnë të trajtohen me dinjitet, dhe mbrojtje më të mirë në çdo fazë dhe në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë penale, nga çdo profesionist që punon me dhe për viktimat.

[Për më shumë](#)



## KONSULTIMI PUBLIK

### Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian për mbrojtjen e viktimave të krimit

Drejtorja e Integritimit dhe Negociatave së bashku me Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Ministrinë e Drejtësisë në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA) zhvilluan takimin e Platformës së Partneritetit Për Integrimin Evropian me temën “Nevoja për miratimin e një Strategjie Kombëtare për mbrojtjen/të drejtat e viktimave të krimit”.

[Për më shumë](#)



## NDËRGJEGJËSIMI



### Ministra e Drejtësisë dhe UNICEF në Shqipëri bashkojnë forcat për të drejtat e fëmijëve

Ministria e Drejtësisë dhe zyra e UNICEF në Shqipëri, organizoi një takim informues me nxënësit e Shkollës së Mesme "Sami Frashëri", Tiranë. mbi Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026 me fokus garantimin e drejtësisë miqësore për fëmijët.

[Për më shumë:](#)

## WORKSHOPE & TRAJNIME

### Projekti Justal – Trajnime mbi procesin raportues

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, pranë Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen e projektit JUSTAL, financuar nga BE, organizoi Workshopin “Forcimi i bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e drejtësisë, përgjegjëse për raportim lidhur me zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021-2025”



### Trajnim mbi konsultimin publik si tregues i qeverisjes së mirë

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, pranë Ministrisë së Drejtësisë u bë pjesë e trajnimit 3 ditor me temë “Konsultimi publik në institucionet e qeverisjes qendrore”.

[Për më shumë](#)

## RISI

### Kolegji Evropian i Bruge me kampus në Tiranë për trajnimin e eurokratëve të rinj

Propozimi i Shqipërisë në Samitin e dhjetorit 2022 në Tiranë është pranuar, dhe Kolegji Evropian - institucioni bazë për trajnimin e eurokratëve të rinj të Ballkanit Perëndimor do të hapë një kampus në Tiranë.

[Për më shumë](#)

### Nga Liria e Tregut tek Agjenda e Gjellbër - vijojnë takimet bilaterale Shqipëri

Nga janari 2023 dhe në vijim të muajit mars vijuan takimet bilaterale kushtuar tregut të brendshëm, lirisë së lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve, kapitalit, konkurrencën si dhe agjendës së gjellbër dhe lidhjes së qëndrueshme.

[Për më shumë](#)



<https://web.facebook.com/drejtesia.gov.al>



[https://www.instagram.com/ministria\\_drejtises/](https://www.instagram.com/ministria_drejtises/)

<https://www.drejtesia.gov.al>